

VENDIM
Nr.597, datë 1.10.2007

PËR MOSDHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT
“TV INFO SHKODRA”
SUBJEKTIT FIZIK: LAIDAN DANI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin nr.375, datë 30.11.2005 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në periudhën maj-qershor 2007, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televisionit,

VENDOSI:

1. Të mos licencojë për transmetim televiziv privat vendor subjektin Laidan Dani, televizioni privat vendor “TV INFO SHKODRA”, pasi në dokumentacionin e paraqitur mungonte:
 - a) Garancia bankare.
2. Subjekti sipas pikës 1 të vendimit, mund të ankohet në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)